



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3000

NR. VENDIMI 2747



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 1777 S.P/ Nr. 3000 Regj.Them
Vendimi 2747

Nr.

Datë 30.06.2021 S.P/Datë 14.09.2021 Regj
20.10.2021.

Datë

Vendimi

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e perbere nga:

GJYQTARE: Oltjona GOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Elisabeta Tusha**, në Tiranë, sot më datë **20.10.2021**, i dha fund shqyrtimit gjyqësor me dyer të hapura të kërkesës penale Nr. **1777/3000 Regj.Them.**, datë e ardhjes së dosjes pranë gjytares 02.07.2021 që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga **prokuror Gjergji Tako**.

TË PANDEHUR:

Ded Nimani, i biri i biri Lulash dhe i Drane, i datëlindjes 26.05.1959, lindur në Pukë dhe banues në Rr. “Gjergj Legisi” Laprakë, banesë private, Tiranë, me arsim tetë vjeçar, me gjëndje civile i martuar, me gjëndje gjyqësore i dënuar, me shtetësi shqiptare, i proceduar me masë sigurimi personal “*arrest në burg*”, përfaqësuar nga Av. Marash Ibraj, me Nr. Liçence 1454 dhe NIPT K0002036I, “*Dhoma e Avokatisë Tiranë*”, i zgjedhur.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”.

BAZA LIGJORE:

Neni 283/1 i Kodit Penal.

Luan Gaçi, i biri Latif dhe i Hume, i datëlindjes 04.01.1978, lindur dhe banues në Rr. Mucaj, banesë private Nr.29, Vorë Tiranë, me arsim tetë vjeçar, me gjëndje civile i martuar, me dy fëmijë, me gjëndje gjyqësore i padënuar, me shtetësi shqiptare, me i identifikuar me letërnjoftimin H80104002I, datë lëshimi 30.12.2020, përfaqësuar nga Av.Robert Karati, Dhoma e Avokatisë Tiranë, me Nr.3100 Licence dhe Nipt K92109005T, Dhoma e Avokatisë Tiranë (i zgjedhur).

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “*Fshehja e të ardhurave*”.

BAZA LIGJORE: Neni 180/a/2 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata, pasi administroi provat, dëgjoji në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët të cilët kërkuan:

-Prokurori: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Ded Nimani për veprën penale parashikuar nga neni 283/1 dhe denimin e tij me 7 vite e gjysëm burgim. Aplikimin i nenit 406 K.Pr.Penale. Deklarimin fajtor i të pandehurit Luan Gaçi për veprën penale parashikuar nga neni 180/2/a/2 i K.Penal dhe denimin e tij me 7 muaj e 15 ditë burgim. Aplikimin e nenit 406 K.Pr.Penale.*”

-Mbrojtësin e të pandehurit Ded Nimani: “*Përfundimisht kërkon nga gjykata që duke marrë në konsiderate rrethanat lehtësuese për të mbrojturin prej tij të caktojë një dënim me 5 vite burgim dhe aplikim e nenit 406 K.Pr.Penale dhe 59 të K.Penal*”;

-I pandehuri Ded Nimani: “*Jam dakort me avokatin e pranoj akuzën, kam dhënë dhe shpejgimet rreth ngjarjes, unë kam qënë në kushte të vështira.*”

-Mbrojtësin e të pandehurit Luan Gaçi: “*Përfundimisht kërkohet nga gjykata që duke marrë në konsiderate rrethanat lehtësuese për të mbrojturin prej tij, të caktohet një denimin me koën e vuajtur me masën arrest në shtëpi*”.

-I pandehuri Luan Gaçi: “*Jam dakort me avokatin tim, jam i penduar, unë jam i vetmi që punoj dhe mbaj familjen.*”

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi;

VËREN SE:

I. Procedura, faktet dhe provat.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit **Ded Nimani**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i

K.Penal dhe në ngarkim të të pandehurit **Luan Gaçi**, akuzuar për veprën penale “*Fshehja e të ardhurave*”, parashikuar nga neni 180/a/2 i K.Penal.

2. Gjykata paraprakisht konstatoi se, bazuar në nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, çështja hynë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate gjykimi i saj.
3. Në seancë paraprake nga ana e të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, u paraqit kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Gjykata si shqyrtoi provat e ndodhura në fashikullin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurve Ded Nimani dhe Luan Gaçi, konstatoi se nga ana e të pandehurëve dhe mbrojtësve të tyre nuk u kërkuar të deklaroheshin akte të pavlefshme apo prova të pa përdorshme, njëkohësisht nga gjykata nuk u konstatuan kryesisht akte absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 128/a të K.Pr.Penale, apo prova të pa përdorshme, gjithashtu gjykata konstatoi se provat në ngarkim të të pandehurve ishin të plota dhe çështja penale mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, ndaj në referim të neneve 332/dh gërma c) dhe 405 të K.Pr.Penale vendosi të pranonte kërkesën e të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre për të proceduar me gjykim të shkurtuar.
4. **Nga shqyrtimi tërësor i akteve të këtij procedimi penal rezulton se:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 15.05.2021, ka regjistruar procedimin penal Nr.3438, për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit Ded Nimani dhe për veprën penale “*Fshehja e të ardhurave*” në ngarkim të të pandehurit Luan Gaçi.
5. Rezulton e provuar se, më datë 14.05.2021 janë arrestuar në flagrancë shtetasit Xhulio Liçi, Luan Gaçi dhe Ded Nimani. Nga seksioni luftës kundër narkotikëve është marrë informacion operativ se shtetasit Luan Gaçi dhe Ded Nimani merreshin me veprimtarinë e blerjes së lëndëve narkotike të forta në sasi relativisht të mëdha. Në rastin konkret informacioni operativ parashtronte se këta shtetas do të blinin një sasi 1 ose 2 kg kokainë për ta shitur më pas me pakicë në qytetin e Tiranës.
6. Policia Gjyqësore ka marrë në vëzhgim këta shtetas në zonën e Plepave në Durërs. Këta shtetas kanë biseduar me njëri tjetrin për pak minuta dhe Luan Gaçi ka hipur në automjetin me targa AA463TO dhe është larguar në drejtim të Ndroqit nëpërmjet rrugës së vjetër ndërsa Ded Nimani, filloi të ecte drejt Kavajës në këmbë. Punonjësit e policisë kanë vijuar të mbajnë në mbikqyrje të pandërprerë Luan Gaçi në zonën e fshatit Zhurë pranë karburantit "Braka Oil". Rreth 1 orë e gjysëm më vonë rreth orës 11.05 një automjet me targa AB 892 BZ është afruar afër automjetit me targa AA 463 TO të Luan Gaçi. Punonjësit e policisë kanë evidentuar si pasagjer Ded Nimani dhe si drejtues një shtetas të panjohur. Në këtë moment shtetasi Luan Gaçi është afruar pranë automjetit nga i cili kanë dalë të dy personat e tjerë. Të tre këta persona kanë shkuar te bagazhi i automjetit me targa AA 892 BZ dhe personi i panjohur ka hapur bagazhin dhe ka nxjerrë andej një pako. Sapo pako është nxjerrë nga bagazhi ka ndërhyrë policia dhe ky person i pa njohur e ka hedhur pakon në rrugë.

7. Policia Gjyqësore i ka shoqëruar të tre këta persona dhe rezultoi se pakoja mbante mbishkrimin "Baroni" dhe mbante një sasi prej 1.088 kg lëndë të dyshuar si kokainë.
8. Personi i panjohur rezultoi të ishte shtetasi Xhuljo Liçi punonjës i forcave "RENEA" në qytetin e Fierit. Shtetasi Xhulia Liçi ka shpjeguar se është punonjës policie në Fier dhe ditën e ngjarjes po udhëtonte nga Fieri në Tiranë. Ai përgjithësisht merr njerëz në rrugën e kthimit në Tiranë për të nxjerrë shpenzimet e udhëtimit. Në zonën e Plepave një person i kishte ngritur dorën dhe ai e kishte marrë. Ky person kishte një pako me vehte të cilën e vendosi në bagazh të makinës dhe nuk kishte komunikime telefonike me ta.
9. Shtetasi Ded Nimani nuk ka dhënë asnjë shpjegim duke u shprehur se është tepër i tronditur emocionalisht.
10. Shtetasi Luan Gaçi është shprehur se e njeh prej disa vitesh shtetasin Ded Nimani dhe ditën e ngjarjes i kishte shërbyer atij si taksi duke pranuar se kryen veprimtarinë e taksisë pa licencë në të zezë. Ai është shprehur se nuk dinte dhe nuk kishte lidhje me veprimtarinë e shitblerjes së lëndëve narkotike.
11. Policia Gjyqësore ka kqyrur aparatet telefonik dhe ka rezultuar se shtetasit Luan Gaçi dhe Ded Nimani kanë bisedime telefonike midis tyre në trajtën e telefonatave dhe jo të mesazheve, pra nuk kuptohet ndonjë gjë thelbësore drejt për drejt nga këto kqyrje telefonash përveç njohjes së mëparshme të këtyre shtetasve.
12. Mbi këto fakte është kërkuar në Gjykatë vleftësim i ligjshëm i arrestimit në flagrancë të tre shtetasve dhe caktimi i masës së sigurimit personal "Arrest në burg". Në Gjykatë i pandehuri Ded Nimani ka vendosur të jepte shpjegime duke parashtruar fabulën se ai ishte poseduesi i lëndës narkotike dhe dy shtetasit e tjerë Luan Gaçi dhe Xhulio Liçi nuk kishin dijeni dhe nuk kishin të bënin me lëndën narkotike. Mbi këto fakte Gjykata ka vendosur masën e sigurisë personale "Arrest në shtëpi" për Luan Gaçi dhe "Arrest burg me afat" për Xhulio Liçi. Në këtë periudhë afati organi procedues duhet të kryente disa veprime hetimore për të sqaruar përfundimisht ngjarjen e më konkretisht:
 1. Thëniet para Gjykatës të Ded Nimani të marrin trajtë procedurale.
 2. Të sqarohet qëndrimi i Xhulio Liçi i cili i parashtron si bashkërisht të interesuar për lëndën narkotike Luan Gaçi dhe Ded Nimani.
 3. Të kqyren përfundimisht aparatet telefonik për të kuptuar nëse ka patur marrëdhënie pararendëse midis Ded Nimani e Luan Gaçi nga njëra anë e Xhulio Liçi nga ana tjetër.
13. Gjatë hetimeve është administruar akti i ekspertimit kimik të lëndës ku ka rezultuar se lënda e sekuestruar është lëndë narkotike e llojit cocainë. Gjithashtu është administruar akti i ekspertimit vlerësues i gjurmëve ku është përcaktuar se në provën materiale "*pako me lëndë të dyshuar kokainë*" nuk u përfatuan gjurmë gishtash.
14. Është pyetur në prani të mbrojtësit i pandehuri Ded Nimani i cili ka konfirmuar thëniet e

tij para Gjykatës proceduralisht duke marrë mbi vehte përgjegjësinë e ngjarjes dhe duke hequr çdo lloj dyshimi mbi Xhulio Liçi dhe Luan Gaçi.

15. Është kryer ballafaqim midis personit nën hetim Xhulio Liçi dhe të pandehurit Luan Gaçi, ku Xhulio Liçi ka sqaruar pozicionin e tij. Ai përfundimisht ka sqaruar se Luan Gaçi nuk i ka folur në vendngjarje asnjë fjalë në lidhje me lëndën narkotike.
16. Është kqyrrur telefoni i të pandehurit Ded Nimani ku nuk është vërejtur asnjë gjë me interes për hetimin.
17. Janë kqyrrur të dy telefonat e personit nën hetim Xhulio Liçi dhe nuk janë vërejtur komunikime me të pandehurit Ded Nimani e Luan Gaçi si në komunikimet e hapura, ashtu dhe në rrjetet sociale.
18. Sa më sipër prokuroria i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objekt si në pjesën hyrëse të këtij vendimi duke argumentuar se: *“Në këto kushte shtetasi Ded Nimani duhet të mbajë përgjegjësi penale për konsumim të nenit 283/1 të K.Penal.*
19. *Shtetasi Luan Gaçi duhet të mbajë përgjegjësi penale për konsumim të nenit 180/2/a/2 të K.Penal pasi ka vetëdeklaruar qartë se punon si taksist në formë të jashtligjshme pa liçencë dhe pa paguar taksa e tatime.*
20. *Shtetasi Luan Gaçi nuk mban përgjegjësi penale për konsumim të neneve 283/1 dhe 300 të K.Penal pasi Ded Nimani me thëniet e tij e ka përjashtuar nga çdo lloj dënie apo përgjegjësi penale.*
21. *Shtetasi Xhulio Liçi nuk mban përgjegjësi penale pasi me qëndrimin e tij Ded Nimani e ka përjashtuar nga çdo lloj dënie apo përgjegjësi penale dhe nga kqyrja e telefonave nuk u përftua asnjë provë shkencore e pandryshueshme nga qëndrime subjektive njerëzish që të tregonte përfshirjen e tij në këtë ngjarje kriminale”.*

II. Vlerësimi i Gjykatës.

22. Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës

penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet goftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

23. Në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit Ded Nimani për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Kjo dispozitë përcakton se: “*Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet*”. **Objekti** i kësaj vepre penale mund të indentifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt dytësor. *Objekti parësor* janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktimë të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj. Ndërsa *objekti dytësor* i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut.
24. Në rastin konkret rezulton që ky objekt është çënuar nga i pandehuri Ded Nimani i cili mbante në kundërshtim me ligjin sasinë e lëndës narkotike prej 1.088 kg kokainë.
25. **Nga ana objektive** legjislatori ka parashikuar se kjo vepër penale mund të kryhet me mënyra të ndryshme si: përmes shitjes, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo forme, transportimit, dërgimit, dorëzimit, **mbajtjes**, shpërndarjes, apo tregtimit *në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij*. Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike.
26. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, t’i krijojë gjykatës bindjen “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “*Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.*”. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të

provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, ***në çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*** shprehet se: *“Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të forta dhe të qarta ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”*.

27. Gjithashtu, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektoj parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”*.
28. Në rastin konkret rezulton e provuar se, më datë 14.05.2021 janë arrestuar në flagrancë shtetasit Xhulio Liçi, Luan Gaçi dhe Ded Nimani. Nga seksioni luftës kundër narkotikëve është marrë informacion operativ se shtetasit Luan Gaçi dhe Ded Nimani merreshin me veprimtarinë e blerjes së lëndëve narkotike të forta në sasi relativisht të mëdha. Në rastin konkret informacioni operativ parashtronte se këta shtetas do të blinin një sasi 1 ose 2 kg kokainë për ta shitur më pas me pakicë në qytetin e Tiranës.
29. Policia Gjyqësore ka marrë në vëzhgim këta shtetas në zonën e Plepave në Durërs. Këta shtetas kanë biseduar me njëri tjetrin për pak minuta dhe Luan Gaçi ka hipur në automjetin me targa AA463TO dhe është larguar në drejtim të Ndroqit nëpërmjet rrugës së vjetër ndërsa Ded Nimani, filloi të ecte drejt Kavajës në këmbë. Punonjësit e policisë kanë vijuar të mbajnë në mbikqyrje të pandërprerë Luan Gaçi në zonën e fshatit Zhurë pranë karburantit "Braka Oil". Rreth 1 orë e gjysëm më vonë rreth orës 11.05 një automjet me targa AB 892 BZ është afruar afër automjetit me targa AA 463 TO të Luan Gaçi. Punonjësit e policisë kanë evidentuar si pasagjer Ded Nimani dhe si drejtues një shtetas të panjohur. Në këtë moment shtetasi Luan Gaçi është afruar pranë automjetit nga i cili kanë dalë të dy personat e tjerë. Të tre këta persona kanë shkuar te bagazhi i automjetit me targa AA 892 BZ dhe personi i panjohur ka hapur bagazhin dhe ka nxjerrë andej një pako. Sapo pako është nxjerrë nga bagazhi ka ndërhyrë policia dhe ky person i pa njohur e ka hedhur pakon në rrugë.
30. Policia Gjyqësore i ka shoqëruar të tre këta persona dhe ka rezultuar se pakoja mbante mbishkrimin "Baroni" dhe brënda saj ishte një sasi prej 1.088 kg lëndë e dyshuar si kokainë.
31. Personi i panjohur rezultoi të ishte shtetasi Xhuljo Liçi punonjës i forcave "RENEA" në qytetin e Fierit. Shtetasi Xhulia Liçi ka shpjeguar se është punonjës policie në Fier dhe ditën e ngjarjes po udhëtonte nga Fieri në Tiranë. Ai përgjithësisht merr njerëz në rrugën e kthimit në Tiranë për të nxjerrë shpenzimet e udhëtimit. Në zonën e Plepave një person i kishte ngritur dorën dhe ai e kishte marrë. Ky person kishte një pako me vehte të cilën e vendosi në bagazh të makinës dhe nuk kishte komunikime telefonike me ta.
32. Shtetasi Luan Gaçi është shprehur se e njeh prej disa vitesh shtetasin Ded Nimani dhe ditën

e ngjarjes i kishte shërbyer atij si taksi duke pranuar se kryen veprimtarinë e taksisë pa liçencë në të zezë. Ai është shprehur se nuk dinte dhe nuk kishte lidhje me veprimtarinë e shitblerjes së lëndëve narkotike.

33. Policia Gjyqësore ka kqyrur aparatet telefonik dhe ka rezultuar se shtetasit Luan Gaçi dhe Ded Nimani kanë bisedime telefonike midis tyre në trajtën e telefonatave dhe jo të mesazheve, pra nuk kuptohet ndonjë gjë thelbësore drejtë për drejtë nga këto kqyrje telefonash përveç njohjes së mëparshme të këtyre shtetasve.
34. Gjatë hetimeve është administruar akti i ekspertimit kimik të lëndës ku ka rezultuar se lënda e sekuestruar është lëndë narkotike e llojit kokainë. Gjithashtu është administruar akti i ekspertimit vlerësues i gjurmëve ku është përcaktuar se në provën materiale "*pako me lëndë të dyshuar kokainë*" nuk u përfatuan gjurmë gishtash.
35. Është pyetur në prani të mbrojtësit i pandehuri Ded Nimani i cili ka pranuar akuzën dhe ka sqaruar se shtetasit Xhulio Liçi dhe Luan Gaçi nuk kishin dijeni për lëndën narkotike.
36. Është kryer ballafaqim midis personit nën hetim Xhulio Liçi dhe të pandehurit Luan Gaçi, ku Xhulio Liçi ka sqaruar pozicionin e tij. Ai përfundimisht ka sqaruar se Luan Gaçi nuk i ka folur në vendngjarje asnjë fjalë në lidhje me lëndën narkotike.
37. Është kqyrur telefoni i të pandehurit Ded Nimani ku nuk është vërejtur asnjë gjë me interes për hetimin.
38. Janë kqyrur të dy telefonat e personit nën hetim Xhulio Liçi dhe nuk janë vërejtur komunikime me të pandehurit Ded Nimani e Luan Gaçi si në komunikimet e hapura, ashtu dhe në rrjetet sociale.
39. Në këto kushte, Gjykata çmon se, në çështjen objekt gjykimi, **provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm** se nga ana e të pandehurit Ded Nimani është konsumuar vepra penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*", parashikuar nga neni 283 i K.Penal.
- 40. Subjekti.** Personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kriteret ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): *i) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm për veprën penale në momentin e kryerjes së saj.* Në rastin konkret, i pandehuri Ded Nimani në kohën e kryerjes së veprës kanë qenë madhor, po ashtu sikurse u theksua në paragrafin e mësipërm, ai është i përgjegjshëm para ligjit, si rrjedhojë ka qenë i aftë të posedoj aftësi intelektuale dhe volive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe për ta kontrolluar atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri Ded Nimani, është subjekt i përgjegjshëm penalisht.
- 41. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale "Prodhimi dhe shitja e**

narkotikëve”, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale **“nullum crimen, nulla poena sine culpa”**, është element i përgjegjësisë penale që parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: *atë intelektual* dhe *atë që lidhet me vullnetin*. Momenti intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Nëpërmjet individualizimit të këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë.

42. Për të qenë para veprës penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet apo motivet që e kanë shtyrë të pandehurin të kryejë këtë vepër penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprimeve të të pandehurit, por mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme lëndën narkotike të llojit Kokainë.
43. Sa më sipër u arsyetua, gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri Ded Nimani, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

-Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

44. Dënimi penal në të drejtën penale kupton atë masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti nëpërmjet Gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtor që kanë kryer vepër penale. Kriteret dhe parimet themelore që duhet të zbatojë Gjykata në caktimin e një dënimi të caktuar, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme, pikërisht në nenin 47 të Kodit Penal. Konkretisht, në këtë dispozitë, sanksionohet se: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.
45. Në mbështetje të parimeve të pasqyruara më lartë, konkludohet se Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, i referohet në rradhë të parë llojit të dënimit dhe kufijve të vendosur në dispozitën ligjore konkrete në bazë të së cilës është bërë cilësimi i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

46. Gjykata, në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, duhet të vlerësojë këto elementë:

- Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Në rastin konkret neni 283 i K.Penal parashikon dënim me burgim nga 5 deri në 10 vjet;
- Rrezikshmërinë e veprës penale. Vepra penale në rastin konkret paraqet rrezikshmëri shoqërore;
- Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale. Autori në rastin konkret paraqet rrezikshmëri shoqërore pasi ai a qenë i dënuar më parë;
- Shkallën e fajit (në rastin konkret vepra penale është kryer në shkallën më të lartë të fajësisë pasi ajo është kryer me dashje);
- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese (rrethanë rënduese në rastin konkret është fakti që i pandehuri ka qenë i dënuar më parë).

47. Në lidhje me rrethanat lehtësuese Gjykata mban parasysh një sërë rrethanash të cilat i konsideron të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit:

- faktin se i pandehuri ka pranuar akuzën, duke shfaqur pendesë të thellë për veprimin e kryer;
- moshën relativisht të madhe të të pandehurit;

48. Sa më sipër, në analizë të të gjitha rrethanave dhe fakteve të kryerjes së veprës penale, të personalitetit të të pandehurit, Gjykata konkludon në lidhje me individualizimin gjyqësor të masës së dënimit, se në rastin konkret ndaj të pandehurit Ded Nimani duhet të caktohet dënimi me 7 (shtatë) vite burgim për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narotikëve*”, të parashikuar nga neni 283 i K.Penal. Gjykata thekson se kjo masë dënimi, është një masë e përshtatshme për të pandehurin, në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si dhe me rrethanat në të cilat ajo është kryer, duke synuar ruajtjen e një raporti të drejtë mes ndëshkimit të fajtorit dhe mbrojtjes së shoqërisë. Gjithashtu, Gjykata në caktimin e një masë të tillë dënimi ndaj të pandehurit mban parasysh edhe parimin se ashpërsia e një penalteti për një vepër penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale.

49. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ded Nimani me 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj burgim.

50. Në lidhje me akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 180/a/2 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit Luan Gaçi. Kjo dispozitë parashikon se: *“Moslëshimi i kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore nga personi, i cili ka detyrimin të lëshojë kuponin tatimor, dëftesën ose faturën tatimore, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Ushtrimi i një aktiviteti tregtar të paligjshëm ose të peregjistruar në organet tatimore, të papajisur me kasë fiskale, sipas dispozitave ligjore në fuqi, ose dhënia e urdhrave në kundërshtim me ligjin, me qëllim moslëshimin e kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me burgim deri në tre vjet”.*

51. Objekti i kësaj figure të veprës penale janë ato marrëdhënie juridike që mbrohen nga kjo dispozitë për të garantuar mbledhjen e saktë të çdo detyrimi tatimor si tatime, taksa apo kontribute të tjera në buxhetin e shtetit. Në rastin konkret ky objekt rezulton i cënuar nga i pandehuri **Luan Gaçi**, i cili nuk ka deklaruar veprimtarinë e tij si taksist pranë organeve tatimore, duke shmangur pagimin e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura sipas legjislacionit të fuqi.

52. Nga ana objektive, kjo veprë penale kryhet me anë të veprimeve të drejtpërdrejta me qëllimin e posaçëm për të realizuar fitime.

53. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim duhet t'i krijojë gjykatës bindjen **“përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”** se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë”.* Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo elementë që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, në çështjen **Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë** shprehet se: *“Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit”.* Në rastin konkret rezulton e provuar se i pandehuri Luan Gaçi ka ushtruar veprimtarinë e taksistit dhe nuk e ka deklaruar atë pranë organeve kompetente me qëllim shmangien nga detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera ligjore.

54. Fakti penal në ngarkim të të pandehurit rezulton i provuar nga: *“Deklarimet e të pandehurit, deklaratat e personave që kanë dijeni për veprën penale, si dhe në tërësi nga aktet e këtij procedimi penal”.* Pra rezultojnë të provuar tejet çdo dyshimi të arsyeshëm elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 180/a/2 i K.Penal.

55. Subjekti, i figurës së kësaj vepre penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): i) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm. Në rastin konkret, i pandehuri Luan Gaçi në kohën e kryerjes së veprës ka qënë madhor dhe i përgjegjshëm para ligjit, si rrjedhojë ai ka qënë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe volutive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t'a kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri Luan Gaçi është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

56. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale *parashikuar nga neni 180/a* Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale "*nullum crimen, nulla poena sine culpa*" është element i përgjegjësisë penale i cili parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: *atë intelektual* dhe *atë që lidhet me vullnetin*. Për të qënë para veprës të parashikuar nga neni 180/a/2 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet, qëllimi, apo motivet që e kanë shtyrë të pandehurin të kryejë këtë vepër penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprës penale, por do të mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Në rastin konkret, i pandehuri **Luan Gaçi** e ka kryer veprën penale me dashje direkte dhe me qëllim fitimi.

57. Sa më sipër, gjykata arrin në përfundimin se provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri **Luan Gaçi** e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe ai duhet të deklarohet fajtor.

-Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

58. Dënimi penal në të drejtën penale kupton atë masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti nëpërmjet Gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer vepër penale. Kriteret dhe parimet themelore që duhet të zbatojë Gjykata në caktimin e një dënimi të caktuar, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme, pikërisht në nenin 47 të Kodit Penal. Konkretisht, në këtë dispozitë, sanksionohet se: "*Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese*".

59. Në mbështetje të parimeve të pasqyruara më lartë, konkludohet se Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, i referohet në rradhë të parë llojit të dënimit dhe kufijve të vendosur në dispozitën ligjore konkrete në bazë të së cilës është bërë cilësimi i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

60. Gjykata, në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, duhet të vlerësojë këto elementë:

- Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Në rastin konkret, parashikohet dënim me burgim deri në tre vite;
- Rrezikshmërinë e veprës penale. Në rastin konkret, vepra penale në ngarkim të të pandehurit paraqet rrezikshmëri shoqërore;
- Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale. Në rastin konkret, autori nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore pasi ai nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale;
- Shkallën e fajit (vepra penale është kryer me dashje që është shkalla më e rëndë e fajësisë);
- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Rrethana rënduese në rastin konkret nuk ka.

61. Në lidhje me rrethanat lehtësuese, gjykata mban parasysh një sërë rrethanash të cilat i konsideron të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit:

- faktin që i pandehuri **Luan Gaçi** si në fazën e hetimeve ashtu edhe në fazën e gjykimit, nuk i është shmangur procedimit penal;
- pranimin se ai e ka kryer veprën penale;
- faktin që i pandehuri **Luan Gaçi** nuk rezulton të ketë qenë i dënuar më parë.

62. Sa më sipër, në analizë të të gjitha rrethanave dhe fakteve të kryerjes së veprës penale, të personalitetit të të pandehurit, Gjykata konkludon në lidhje me individualizimin gjyqësor të masës së dënimit, se në rastin konkret ndaj të pandehurit Luan Gaçi duhet të caktohet dënimi me 7 (shtatë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 180/a/2 i K.Penal. Gjykata thekson se kjo masë dënimi, është një masë e përshtatshme për të pandehurin, në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si dhe me rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, duke synuar ruajtjen e një raporti të drejtë mes ndëshkimit të fajtorit dhe mbrojtjes së shoqërisë. Gjithashtu, Gjykata në caktimin e një masë të tillë dënimi ndaj të pandehurit mban parasysh edhe parimin se ashpërsia e një penalteti për një vepër penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale.

63. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Luan Gaçi me 5 (pesë) muaj burgim. Dënim të cilin i pandehuri e ka vuajtur për shkak të masës së sigurimit personal sigurimit “Arrest në shtëpi”.

64. Në zbatim të nenit 261/c të K.Pr.Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, caktuar ndaj të pandehurit **Luan Gaçi**, me Vendimin Nr. 772 Akti, datë 17.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

65. Në referim të nenit 190 i K.Pr.Penale, provat materiale të sekuestruara me Proces-verbalin datë 14.05.2021, lënda narkotike në pjesën e mbetur pas ekspertimit të asgjësohet, ndërsa sendet e tjera t’u kthehen pronarëve të tyre të ligjshëm.

-Lidhur me shpenzimet procedurale.

66. Duke qenë se, të pandehurit Ded Nimani dhe Luan Gaçi, u deklaruan fajtor dhe u dënuan për veprat penale për të cilat akuzohen, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore u ngarkohen të pandehurëve solidarisht.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 283/1, 180/a/2, 47,48, 49, të K.Penal dhe në nenet 190, 379, 383, 384, 388 dhe 406/1 të K.Pr.Penale:

VENDOSI

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ded Nimani**, për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 7(shtatë) vite burgim.
2. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Ded Nimani** me 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj burgim.
3. Në vuajtjen e dënimit të përllogaritet koha e paraburgimit për të pandehurin **Ded Nimani** nga data e arrësimit të tij më datë 14.05.2021 dhe pjesa e pavuajtur e dënimit të vuhet në një burg të siguriusë se zakonshme.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Luan Gaçi**, për veprën penale “*Fshehja e të ardhurave*”, parashikuar nga neni 180/a/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 7(shtatë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim.
5. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Luan Gaçi** me 5 (pesë) muaj burgim.
6. Në zbatim të nenit 261/c të K.Pr.Penale, konstatohet shuarja e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, caktuar ndaj të pandehurit **Luan Gaçi**, me Vendimin Nr. 772 Akti, datë 17.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
7. Në referim të nenit 190 të K.Pr.Penale, provat materiale të sekuestruara me proces-verbalin e datës 14.05.2021, lënda narkotike e mbetur pas ekspertimit të asgjësohet, ndërsa sendet e tjera t’u kthehen pronarëve të tyre të ligjshëm.

8. Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim të të pandehurëve solidarisht..
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 20.10.2021.

SEKRETARE

GJYQTARE

Elisabeta TUSHA

GOXHA

Oltjona

Shpenzime gjyqësore:

Njoftime: 450 lekë

Shpenzime në hetim:9.000 lekë